



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 671/ 2 prot

Datë 20.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-86181-11-02-2023 me objekt **“Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT” për 12 muaj**” me fond limit 1,409,700.00leke pa TVSH, zhvilluar me datë 15-01-2024 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK me Nipt L28029301Q dhe Adresa: *Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit*
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane
Adresa: *Rruga e Dibres Nr. 372, Tirane*

Në datën 19.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3911, si dhe nr. protokollit 671/2024 datë 19.03.2024 i operatorit ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar”, me nr REF-86181-11-02-2023 me objekt “Trajtim dhe asgjësim i mbetjeve citostatike dhe citotoksike në QSUNT” për 12 muaj” me fond limit 1,409,700.00leke pa TVSH, zhvilluar me datë 15-01-2024 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK në ankesën nr. 671 datë 19.03.2024 pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Referuar shkresës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, administruar pranë me nr. 230/5 prot., datë 12.02.2024, ku thuhet shprehimisht se:

“... trupa inspektuese pranë kësaj drejtorie konstatoi se subjekti në vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit ka në funksion 1 (një) pajisje incenerimi, ndryshe nga çfarë është e miratuar në lejen mjedisore që disponon.

Për këtë arsye, ndaj subjektit “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për lejen mjedisore të tipit A me PN-8024-01-2019 me aktivitet “Incenerim i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incenerimi” në bazë të ligjit nr 10448 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, datë 07.04.2011, neni 29, pika 1, gërma c si dhe Neni 16, pika 3 është marrë masë;

Dënim administrativ kryesor:

Gjobe 1000000 Lekë (...); Neni 29, pika 3 propozojmë: pezullimin e lejes mjedisore tipi A, me PN-8024-01-2019, deri në realizimin e detyrave të lëna për përshtatjen e lejes mjedisore me instalimin në vendndodhjen.”

Referuar këtij komunikimi, duke u bazuar në ligjin nr. 10448/2011 dhe ligjin nr. 10431/2011, si dhe referuar nenit 82(2) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, OE, për këtë objekt prokurimi nuk krijon bindjen për zbatimin me sukses të kontratës në të ardhmen, duke qenë se ka një procedurë administrative, e cila mund të pasojë në pezullimin apo shfuqizimin e lejes së mjedisit, me të cilën paraqitet në këtë procedurë.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.03.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro